



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 283/1 prot.

Tiranë, më 22.02.2019

VENDIM
Nr.16, datë 22.02.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 237, DATË 06.12.2017, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË DEVOLL

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 237, datë 06.12.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Devoll dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me anë të programit të verifikimit nr.406/1 prot, datë 13.04.2018 “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 237, datë 06.12.2017, “Për miratimin e Raportit Përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Devoll dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ të Vendimit nr. 237, datë 06.12.2017 të Komisionerit, njoftuar institucionit me shkresën nr. 406/2 prot, datë 13.04.2018, “Për fillim verifikimi”.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit Nr. 94, datë 25.04.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Devoll”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Devoll.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas përfundimit të mbikëqyrjes, ka dërguar pranë Bashkisë Devoll Raportin Përfundimtar lidhur me administrimin e shërbimit civil dhe Vendimin paralajmërues nr. 237, datë 06.12.2017, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, në detyrat e lëna për Bashkinë Devoll, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë dhe pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezultojnë si më poshtë:

- Në pikën 2 të Vendimit paralajmëruar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është kërkuar nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Devoll të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhëniet e punës së punonjësit ***** në pozicionin e punës “Specialist i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve” dhe ta shpallë atë të lirë, për ta plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, e në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Devoll.

Për plotësimin e rekomandimit të mësipërm, është nxjerrë Urdhri nr. 104, datë 23.04.2018, i Kryetarit të Bashkisë “Për largimin nga detyra” të ***** dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës në po të njëjtën ditë me atë të marrëdhënies financiare.

Nga komunikimi me njësinë përgjegjëse të Bashkisë Devoll, në dispozicion të grupit të punës u vu edhe listë prezence e muajit Maj 2018 nga ku rezultojnë se punonjësi në fjalë nuk është në marrëdhënie pune me institucionin.

Në vijim të komunikimit, grupi i punës u informua se pozicioni i punës “Specialist i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve” është plotësuar nga nëpunësja

***** (deklaruar si nëpunëse civile në kategorinë ekzekutive), rasti i të cilës do të trajtohet gjatë analizës së zbatimit të pikës 3 në vijim.

- Në pikën 3 të vendimit objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e institucionit të konstatojë si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm aktin e emërimit, nr. 483, datë 30.06.2016, të punonjësës *****, në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, të ndërpresë marrëdhëniet e punës për këtë punonjëse në pozicionin në fjalë dhe të vlerësojë mundësinë e rikthimit të saj në pozicionin e punës në të cilin ajo është deklaruar si nëpunëse civile (në kategorinë ekzekutive).

Gjatë verifikimit në subjekt, grupi i punës konstatoi se, me Urdhrin Nr. 105, datë 24.04.2018, Kryetari i Bashkisë ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësën ***** (vërtetuar kjo edhe nga Lista prezenca - Borderoja për muajin Prill 2018 e marrë nga Financa, firmosur nga Specialistia e Burimeve Njerëzore) dhe me aktin Nr. 1146 prot., datë 24.04.2018, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 483, datë 30.06.2016 dhe është vendosur transferimi i përkohshëm i saj për një periudhë deri në 6-muaj në pozicionin “Specialist i Burimeve Njerëzore” në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkak të largimit të ***** me leje lindje.

Pas përfundimit të afatit 6-mujor, me aktin nr. 1148/1 prot., datë 01.10.2018, të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore kjo punonjëse është transferuar në mënyrë të përhershme në pozicionin e punës “Specialist i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve” (pozicion i kategorisë ekzekutive, i barasvlershëm me atë që ka pasur në momentin e deklarimit të statusit si nëpunëse civile).

Nga këqyrja e këtij akti, grupi i punës vëren se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Devoll ka gabuar kur ka përdorur institutin e transferimit të përhershëm të kësaj punonjëseje në pozicionin e mësipërm pasi, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 152/2013, transferimi i përhershëm kryhet vetëm në disa raste specifike, si më poshtë:

- a) Në rastin e gjendjes së paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozicionit të mëparshëm;
- b) Shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit sipas nenit 52 të këtij ligji.
- c) Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit.

Në kushtet kur tashmë, punonjësja ka kaluar në një pozicion të kategorisë ekzekutive të barasvlershëm me pozicionin që ajo ka mbajtur në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, kjo pikë e dispozitivit të vendimit të Komisionerit do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen njësisë përgjegjëse të institucionit që të zbatojë me korrektësi ligjin dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.

- Në lidhje me rekomandimin për plotësimin e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil (pika 4 e vendimit paralajmërues), grupi i punës konstatoi se:

Njësia përgjegjëse ka zbatuar rekomandimin sipas orientimit të lënë në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe në Vendimin e paralajmërimit nr. 237, datë 06.12.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Konkretisht, në dosjet e personelit për çdo nëpunës civil, janë përfshirë, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Sa u relatua më sipër, u konstatua nga grupi i mbikëqyrjes në selinë e Bashkisë Devoll dhe proces-verbali administrativ u nënshkrua pa vërejtje nga titullari dhe njësia përgjegjëse e institucionit dhe është bashkëlidhur relacionit, së bashku me një kopje të vendimit paralajmërues të Komisionerit.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se, nga ana e njësisë përgjegjëse janë marrë të gjitha masat për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 237, datë 06.12.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Devoll dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Devoll, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 237, datë 06.12.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Devoll.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha